

VENDIM
Nr. 339, datë 13.5.2026

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 760, DATË 13.12.2024,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK,
TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË
PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT ‘ZGJERIMI I RRUGËS
ELBASAN–PËRRENJAS–QAFËTHANË (FAZA III)’”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 760, datë 13.12.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Zgjerimi i rrugës Elbasan–Përrenjas–Qafëthanë (faza III)’”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pikat 3 dhe 4 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “arë”, “truall” dhe “ndërtesë”, me një vlerë të përgjithshme prej 14 724 608 (katërmëdhjetë milionë e shtatëqind e njëzet e katër mijë e gjashtëqind e tetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 14 724 608 (katërmëdhjetë milionë e shtatëqind e njëzet e katër mijë e gjashtëqind e tetë) lekësh, përballohet nga buxheti i shtetit, llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.”

b) Në tabelën, që i bashkëlidhet vendimit, bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

i. të dhënat për shpronësim të numrit rendor 10 të tabelës, bashkëlidhur vendimit, zëvendësohen me të dhënat me të njëjtin numër rendor sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

ii. tabelës, bashkëlidhur vendimit, i shtohen pasuritë me numra rendorë 14–22 sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

iii. togfjalëshi “Vlera totale 684 342” zëvendësohet me “Vlera totale 14 724 608”.

2. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

3. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore Librazhd, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Elbasan dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, TË CILËT SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK, PËR REALIZIMIN E

PROJEKTIT “ZGJERIMI I RRUGËS ELBASAN–PËRRENJAS–QAFËTHANË (FAZA III)” (NDRYSHIMI DHE SHITESAT)

Nr. rendor	Pronari			Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)					Vlerësimet për shpronësim									Shënime	
	Emër	Atësi	Mbiemër	Adresa	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqe totale	Shpronësimi “arë”			Shpronësimi "truall"			Shpronësimi “ndërtesë”				Totali
									Sip. (m²)	Çmimi (lek/m²)	Vlera (m²)	Sip. (m²)	Çmimi (lek/m²)	Vlera (m²)	Sip. (m²)	Çmimi (lek/m²)	Vlera me preventiv punimesh		
10	Xhemal	Musa	Hasani	Mirakë	2696	56	Arë	1283	36	174	6,264							6,264	
14	Rexhep	Qemal	Hasani	Mirakë	2629	54	Arë	952	143	174	24,882							24,882	
15	Sulejman	Sherif	Hasani	Mirakë	2629	55	Arë	1395	221	174	38,454							38,454	
16	Qani	Abedin	Hasani	Mirakë	2696	57	Arë	1370	152	174	26,448							26,448	
17	Osman	Ismail	Tola	Mirakë	2696	77	Arë	2173	241	174	41,934							41,934	
18	Xhemal	Murat	Tola	Mirakë	2696	86	Arë	1393	18	174	3,132							3,132	
19	Xhemal	Murat	Tola	Mirakë	2696	95	Arë	637	319	174	55,506							55,506	
20	Xheladin	Muhamet	Tola	Mirakë	2696	100	Arë	606	40	174	6,960							6,960	
21	Hysen	Islam	Tola	Mirakë	2696	108	Arë	1007	2	174	348							348	
22	Sofokli	Koli	Bualli	Mirakë	2696	147/3	Truall	242				242	240	58,080	500.9		13,778,780	13,836,860	